



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I FILOLOGJISË  
PRISHTINË

Pranuar më: 20.06.2012			
Nj. org.	Numer	Shtojca	Vlera
03	3532	3	-

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

Fakulteti

i Filologjisë

Lëndët

1. Hyrje në gramatikën e gjuhës gjermane, 2.  
Gjuhë gjermane I, 3. Gramatikë e gjuhës  
gjermane, 4. Gjuhë gjermane II

Kandidatët e paraqitur

1. Arbnora Bajraktari  
2. Elton Krivonjeva  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Komisioni vlerësues

1. Kryetar
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Teuta Abrashi  
Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hamiti  
Prof. Ass. Dr. Blerë Ismajli





## Raport dhe propozime të komisionit për vlerësimin e kandidatëve të paraqitur në Konkursin për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ushtrime për vitin akademik 2021/2022

Komisioni në përbërje: 1. Prof. Asoc. Dr. Teuta Abrashi (kryetare), 2. Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hamiti, 3. Prof. Ass. Dr. Blertë Ismajli, i miratuar nga Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, pasi shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur në konkursin me nr. prot. 01/217, dt. 01/06/2022, shpallur nga UP në uebfaqen zyrtare, si dhe duke u mbështetur në dispozitat e Statutit të UP-së,

### PROPOZON

- Që për vitin akademik 2021/2022, **për pikën III.7:**

Një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime për lëndët:

**1. Hyrje në gramatikën e gjuhës gjermane, 2. Gjuhë gjermane I, 3. Gramatikë e gjuhës gjermane, 4. Gjuhë gjermane II**

**Të angazhohet kandidatja e paraqitur MA Arbnora Bajraktari**

Në konkurs janë paraqitur dz kandidatë. Në vijim po e paraqesim raportin për secilin prej tyre.

#### Propozohet:

**MA Abnora Bajraktari** (19.08.1997) ka mbaruar studimet BA me notë mesatar 9.35 dhe MA me notë mesatare 9.55 në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane të Fakultetit të Filologjisë (UP). Studimet MA i ka përfunduar me mbrojtjen e temës në fushën e gjuhësisë. Ajo është shpallur Studente e Dalluar në vitin akademik 2018/19. Në vitin akademik 2021/2022 është regjistruar në studimet PhD në drejtimin "Gjuhësi" në Fakultetin e Filologjisë, UP. Në suaza të interesimeve të saj për fushën e gjuhësisë ka marrë pjesë në shkollën verore "Mehrsprachigkeit" (Shumëgjuhësia), organizuar nga Universiteti Vechta, Gjermani dhe në trajnimin "Empirische Forschungsmethoden in DaF" (Metodat empirike të hulumtimit në gjermanishten si gjuhë e huaj), organizuar nga DAAD. Poashtu ka marrë pjesë në konferenca dhe trajnime ndërkombëtare në fushën mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj. Në vitin akademik 2021/2022 ka qenë e angazhuar në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane për ushtrime në grup lëndësh nga fusha e gjuhësisë. Në periudhën 2017-2020 ka punuar në zyrën ndërlidhëse të DAAD në Prishtinë, ndërsa nga viti 2018



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

është angazhuar si mësimdhënëse e gjermanishtes si gjuhë e huaj. Gjatë studimeve ka qëndruar për një semestër në Universitetin e Freiburgut si bursiste e ERASMUS+. Kandidatja ka edhe certifikatën e Goethe Institutit për njohjen e gjermanishtes në nivelin C2. Bazuar në notën më të lartë mesatare, moshën, angazhimin e saj edhe në fushën e gjuhësisë gjermane krahas mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj, si dhe përkushtimit të treguar në punën e saj në Departament gjatë vitit akademik 2021/2022 kur ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtoresh e jashtme, komisioni propozon që MA Arbnore Bajraktari të angazhohet në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime për lëndët: 1. Hyrje në gramatikën e gjuhës gjermane, 2. Gjuhë gjermane I, 3. Gramatikë e gjuhës gjermane, 4. Gjuhë gjermane II.

**Refuzohen:**

**MA Elton Krivonjeva** (28.01.1995) ka mbaruar studimet BA (8.32) dhe MA (8.84) në Departamentin e Gjuhës dhe të Letërsisë Gjermane të Fakultetit të Filologjisë (UP). Studimet MA i ka përfunduar me mbrojtjen e temës në fushën e letërsisë. Në vitin akademik 2020/21 i ka regjistruar studimet PhD në drejtimin "Gjuhësi" në Fakultetin e Filologjisë të UP-së. Kandidati ka disa dëshmi për pjesëmarrje në trajnime në fushën e metodologjisë së mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj dhe disa certifikata për trajnime në fushën e metodologjisë së mësimdhënies në përgjithësi. Ai ka përvojë gjashtëvjeçare si mësimdhënës i gjermanishtes si gjuhë e huaj në shkolla të mesme, kurse gjuhe dhe në kolegjin Universum. Kandidati refuzohet meqë ka notë më të ulët mesatare se kandidatja që propozohet. Poashtu ai ka përfunduar studimet MA në fushën e letërsisë dhe nuk dëshmon ndonjë angazhim në fushën e gjuhësisë gjermane (pjesëmarrje në konferenca, trajnime, workshope etj.).

Komisioni vlerësues

1. Kryetare
2. Anëtar
3. Anëtar

Prof. Asoc. Dr. Teuta Abrashi

Prof. Asoc. Dr. Vjosa Hamiti

Prof. Ass. Dr. Blertë Ismajli